



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr. 0803-61
4.3.2024
Shkup

Në pajtim me nenin 18, paragrafi (1), nënparagrafi 2, nenin 82, paragrafi (1), nënparagrafi 6 dhe nenin 83 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr.184/13, 13/14, 44/ 14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 42/20, 77/21 dhe nr. 124/15), nenin 28 të Ligjit të Kontesteve Administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 96/19), nenin 24 të Rregullores për Procedurën e Veprimtarisë Financiare dhe Kontabilitetit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, nr. ark. 01-6222/1, datë 12.12.2014, duke vepruar sipas Propozimit PA1 nr. 0803-61, datë 16.2.2024 për iniciimin e procedurës për heqjen dhe Propozimin PA1 nr. 0803-61, datë 29.2.2024. për miratimin e Vendimit për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive “RADIO HIT FM” ShPKNjP Shkup, në pajtim me Konkluzionin, nr. ark. 0201-1054/2, datë 1.3.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele në seancën e 8-të, mbajtur më 1.3.2024, miratoi:

VENDIM

**për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive
“RADIO HIT FM” ShPKNjP – Shkup**

1. I HIQET leja për transmetim në radio, nr. 08-78 datë 7.9.2023 Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive “RADIO HIT FM” ShPKNjP – Shkup, për shkak të mospagesës së kompensimit vjetor të lejes për transmetim në radio në afatin e paraparë ligjor – 30 ditë nga dita e pranimit të faturës nr.2024-100-0038 datë 11.01.2024 (nr. ynë ark. 0503-201/1, datë 11.01.2024).

2. Fatura nr. 2024-100-0038 datë 11.01.2024 (nr. ynë ark. 0503-201/1 datë 11.01.2024), ndalohet edhe subjekti sipas pikës 1 të këtij vendimi, i jepet faturë e re, e cila i referohet vetëm periudhës së punës, respektivisht deri në ditën e miratimit të këtij vendimi për heqjen e lejes, e cila duhet të paguhet deri në miratimin e këtij vendimi për heqjen e lejes, e cila duhet të paguhet për 8 (tetë) ditë nga dita e dhënies së lejes. Ky vendim botohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe në uebfaqen e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësive joshumicë, por që e flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. Ky vendim është përrundimtar.

A r s y e t i m

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (ShTR) “RADIO HIT FM” ShPKNjP, Shkup është zotërues i lejes për transmetim në radio, nr. 08-78, datë 7.9.2023, e cila transmeton program përmes radiofrekuencës, në nivel rajonal, për zonën D1 Cërn Vërv – zona e nivelit rajonal Shkup, shërbimi programor radio folës-muzikor me format të përgjithshëm kryesisht argëtues, në gjuhën maqedonase.

Në pajtim me nenin 80, paragrafi (1) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), për lejen për transmetim në radio ose televizion transmetuesit,

me përjashtim të shërbimit transmetues publik në radio ose televizion paguajnë kompensim vjetor Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) në pajtim me këtë ligj. Kompensimi vjetor paguhet për çdo vit aktual duke filluar nga data e dhënies së lejes për transmetim televiziv ose radio në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia (neni 80, paragrafi 5 i LSHMAAV).

Lidhur me kompensimin e lejes për radiodifuzion të ShTR "RADIO HIT FM" ShPKNJ P – Shkup, nr. 08-78, datë 9.7.2023, Agjencia me 1.11.2024, ka dërguar Faturë nr. 2024-100-0038 datë 11.1.2024 (nr. ynë ark. 0503-201/1, datë 11.1.2024) për kompensim të lejes, sipas së cilës transmetuesi kishte detyrimin të paguante 279,321.00 (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind e njëzet e një) denarë për kompensim vjetor për lejen e transmetimit në radio, për periudhën prej 5.1.2024 deri më 4.1.2025. Në Agjenci në libër është shënuar se fatura është pranuar në rregull më 12.1.2024.

Në pajtim me nenin 27, paragrafi (1) të LShMAAV, Agjencia kryen mbikëqyrje administrative, mbi punën e botuesve të mediave nga aspekti i pajtueshmërisë së veprimtarisë së tyre me kushtet e përcaktuara në Ligjin e Medieve, Ligjin e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe rregulloret e miratuara në bazë të tij (neni 29, paragrafi 1 i LShMAAV).

Agjencia, nëpërmjet Sektorit të financave dhe të logjistikës, ka kryer mbikëqyrje administrative të veprimtarisë së ShTR "RADIO HIT FM" ShPKNJ P – Shkup, nga aspekti i përmbushjes së detyrimit për pagesën e kompensimit vjetor për leje, dhe pas mbikëqyrjes së rregullt administrative në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative (nr. ynë ark. 0503-785/1, datë 16.2.2024), ka konstatuar se transmetuesi në fjalë nuk e ka përmbushur detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin 80, paragrafi (5) të LShMAAV, për pagesë të kompensimit vjetor të lejes për transmetim në radio në llogarinë e Agjencisë.

Përkatësisht sipas faturës së dorëzuar nr. 2024-100-0038 datë 11.1.2024 (nr. ynë ark. 0503-201/1 datë 11.1.2024), ShTR "RADIO HIT FM" ShPKNJ P – Shkup, ka pasur detyrim të paguajë 279.321,00 (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind e njëzet e një) denarë për një vit kompensimin vjetor për transmetim në radio për periudhën prej 5.1.2024 deri më 4.1.2025. Që nga 10.2.2024 kur ka qenë afati ligjor për pagesën e kompensimit, ShTR "RADIO HIT FM" ShPKNJ P – Shkup, nuk ka kryer pagesë në shumë prej 279.321,00 (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind e njëzet e një) denarë.

Në nenin 23, paragrafi (1), paragrafi (3) të LShMAAV, është përcaktuar se nëse nuk respektohen, shkelen dispozitat e LSHMAAV dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij, si dhe kushtet dhe detyrimet e përcaktuara në leje dhe aktet e tjera të Agjencisë, ndaj botuesit të medias, Këshilli i Agjencisë mund të ndër marrë masë – heqje të lejes.

Në pajtim me nenin 82, paragrafi (1), nënparagrafi 6 të LShMAAV, Agjencia do të heqë lejen për transmetim televiziv ose radio, para skadimit të afatit për të cilën është dhënë dhe do ta fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve, pas dorëzimit paraprak të njoftimit me shkrim, nëse zotëruesi i lejes nuk e paguan kompensimin për leje brenda afatit të përcaktuar me ligj.

Procedurën për heqjen e lejes për transmetim televiziv ose radio, në pajtim me nenin 83 paragrafi (1) të LShMAAV, e inicion Këshilli me propozim të drejtorit të Agjencisë.

Për shkak të gjendjes faktike të vërtetuar, sipas së cilës zotëruesi i lejes, ShTR "RADIO HIT FM" ShPKNJ P – Shkup, në afatin ligjor prej 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia, nuk e ka përmbushur detyrimin sipas nenit 80, paragrafi (5) të LShMAAV, gjegjësisht zotëruesi i lejes nuk ka paguar kompensimin e lejes për transmetim në radio në afatin e përcaktuar ligjor, personi i autorizuar nga drejtori i Agjencisë, në pajtim me nenin 83, paragrafi (1), dhe në lidhje me nenin 82, paragrafi (1), nënparagrafi 6 të LShMAAV, dorëzon Propozimin PA1 nr. 0803-61 datë 16.2.2024 për inicimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të ShTR "RADIO HIT FM" ShPKNJ P – Shkup.

Këshilli i Agjencisë në seancën e 6-të mbajtur më 19.2.2024, konform Konkluzionit, nr. ark. 0201-773/18 datë 19.2.2024, miratoi Propozimin PA1 nr. 0803-61 datë 16.2.2024, për inicimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të ShTR "RADIO HIT FM" ShPKNJ P – Shkup.

Në lidhje me procedurën e iniciuar për heqjen e lejes të ShTR “RADIO HIT FM” ShPKNjP – Shkup, nr. 08-78 datë 7.9.2023, dhe në pajtim me nenin 82, paragrafi (1) të LShMAAV, Agjencia i ka dërguar njoftim transmetuesit në fjalë (PA1 nr. 0803-61 datë 21.2.2024), në të cilën i është thënë se nëse nuk e paguan kompensimin vjetor të lejes për transmetim në radio në pajtim me nenin 83, paragrafi (3) të LShMAAV, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga pranimit i Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, PA1 nr. 0803-61 datë 16.2.2024, do të miratojë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio, pas së cilës, në pajtim me nenin 85, paragrafi (2) të LShMAAV, transmetuesi do të fshihet nga regjistri i transmetuesve.

Njoftimi PA1 nr. 0803-61 datë 21.2.2024 i është dorëzuar me shkrim ShTR “RADIO HIT FM” ShPKNjP – Shkup, dhe i njëjti është pranuar në rregull nga transmetuesi më 21.2.2024.

Në pajtim me nenin 83, paragrafi (3) të LShMAAV, Këshilli është i detyruar që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të propozimit të drejtorit të iniciojë procedurë për heqjen e lejes, të marrë vendim me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit.

Duke marrë parasysh faktin se zotëruesi i lejes ShTR “RADIO HIT FM” ShPKNjP – Shkup, nr. 08-78 datë 7.9.2023 dhe brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga data e marrjes së Propozimit PA1 nr. 0803-61 datë 16.2.2024, nga anëtarët e Këshillit të Agjencisë, nuk ka përmbushur detyrimin e parashikuar në nenin 80, paragrafi (5) të LShMAAV, drejtori i Agjencisë ka paraqitur Propozimin nr. 0803-61 datë 29.2.2024 sipas të cilit Këshilli i Agjencisë në pajtim me nenin 82, paragrafi (1), nënparagrafi 6 dhe nenin 83, paragrafi (3) të LShMAAV, dhe sipas Konkluzionit të Agjencisë, nr. ark. 0201-1054/2 datë 1.3.2024 miratoi Vendimin për heqjen e lejes nr. 08-78 datë 7.9.2023 për transmetim në radio të ShTR “RADIO HIT FM” ShPKNjP – Shkup, për faktin se zotëruesi i lejes nuk e ka përmbushur detyrimin sipas nenit 80, paragrafi (5) të LShMAAV, gjegjësisht nuk e ka paguar kompensimin për lejen e transmetimit në radio në afatin e përcaktuar me ligj.

Në pajtim me nenin 24 të Rregullores për Procedurat e Veprimtarisë Financiare dhe të Kontabilitetit të Agjencisë, nëse zotëruesi i lejes për transmetim televiziv ose radio nuk paguan kompensimin, pasi të jetë dorëzuar fatura brenda afatit të përcaktuar në paragrafin (3) të këtij neni të Rregullores, anulohet dhe i jepet faturë e re që i referohet vetëm periudhës së veprimtarisë, e cila faturë paguhet jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e dhënies së saj. Përndryshe, arkëtimi i borxhit bëhet me rrugë gjyqësore.

Për rrjedhojë Fatura nr. 2024-100-0038 datë 11.1.2024, (nr. ynë ark. 0503-201/1 datë. 11.1.2024) për kompensim të lejes për transmetim në radio, anulohet dhe ShTR “RADIO HIT FM” ShPKNjP – Shkup, i jepet faturë e re, e cila i referohet vetëm periudhës së veprimtarisë, pra deri në ditën e miratimit të këtij vendimi për heqjen e lejes dhe do të duhet të paguhet jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e dhënies së saj.

Në pajtim me nenin 84 të LShMAAV, Vendimi për heqjen e lejes për transmetim në radio është përfundimtar, ndërkaq kundër këtij vendimi zotëruesi i lejes ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Procedura në gjykatën kompetente është urgjente.

Bazuar në sa më sipër është marrë Vendimi si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuele,
Kryetari i Këshillit,
Llazo PETRUSHEVSKI, d.v**

Këshillë Juridik: Kundër këtij vendimi për marrjen e lejes, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive ShTR “RADIO HIT FM” ShPKNjP – Shkup, ka të drejtë të paraqesë padi për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.